# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 23

**Tiranë – E mërkurë, 15 shkurt 2017**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 3.2.2017 | Për ngritjen, në Shqipëri, të Qendrës së Ekselencës së NATO-s për studimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj | 1769 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 3.2.2017 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtim, sistemim dhe asfaltim i rrugëve e trotuareve", në Bashkinë e Hasit | 1770 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 71, datë 3.2.2017 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i shëtitores 'Ali Pasha', restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh", Bashkia Tepelenë | 1770 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 3.2.2017 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të lagjeve në Kodër–Vorë, loti 1", Bashkia Vorë | 1771 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 3.2.2017 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike", Bashkia Elbasan | 1772 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 8.2.2017 | Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Shijak, të pronës nr. 1131, me emërtim "Ish-spitali", me vendndodhje në Shijak, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 839, datë 22.7.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shijak, të qarkut të Durrësit" | 1773 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 8.2.2017 | Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të disa objekteve dhe të disa sipërfaqeve nga trualli funksional i pronës nr. 904, me emërtim "Akademia e Detarisë", me vendndodhje në Skelë, Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar......... | 1774 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 8.2.2017 | Për përcaktimin e procedurave të dorëzimit vullnetar të armëve të zjarrit të çdo lloji dhe trajtimin e tyre nga strukturat e Policisë së Shtetit......... | 1777 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 8.2.2017 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 5.10.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", të ndryshuar......... | 1779 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 84, datë 8.2.2017 | Për një ndryshim në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"......... | 1780 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 8.2.2017 | Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor......... | 1785 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 8.2.2017 | Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë me nr. 2/292, vol. 35., fq.3, ZK8160, me emërtimin "Parku i lojërave për fëmijë në Rrugën e Elbasanit", aktualisht në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes......... | 1789 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 8.2.2017 | Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 19.2.2009, nr. 616, datë 11.6.2009, nr. 1039, datë 14.10.2009, nr. 389, datë 19.5.2010, nr. 435, datë 24.4.2013, nr. 494, datë 19.6.2013, nr. 685, datë 16.8.2013, nr. 760, datë5.9.2013, nr. 869, datë 10.12.2014, nr. 258, datë 25.3.2015, nr. 449, datë 27.5.2015, nr. 616, datë 7.7.2015, nr. 801, datë 30.9.2015, nr. 910, datë 11.11.2015, nr. 220, datë 23.3.2016, nr. 378, datë 25.5.2016, nr. 529, datë 20.7.2016 dhe nr. 563, datë 29.7.2016 "Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale"......... | 1793 |
| Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 1, datë 3.2.2017 | Për procedurën e hedhjes së të dhënave në arkivin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar......... | 1804 |
| Urdhër i ministrit të Integrimit Europian nr. 5/1, datë 20.1.2017 | Për delegim kompetence......... | 1807 |

**VENDIM**
**Nr. 58, datë 3.2.2017**

## PËR NGRITJEN, NË SHQIPËRI, TË QENDRËS SË EKSELENCËS SË NATO-s PËR STUDIMIN E FENOMENIT TË LUFTËTARËVE TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen, në Shqipëri, të Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj (NATO Center of Excellence for Foreign Fighters – NATO CoE FF).

2. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj do të ushtrojë aktivitetin brenda garnizonit "Skënderbej". Ministria e Mbrojtjes siguron pajisjet dhe të gjithë mbështetjen logjistike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe për funksionimin e qendrës.

3. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj është institucion qendror, në varësi të ministrit të Mbrojtjes, dhe ka personalitet juridik publik.

4. Misioni i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, është kontributi në fushën studimore dhe edukuese për informimin e vendimmarrësve, në nivel kombëtar, dhe përgatitjen e punonjësve civilë e ushtarakë të agjencive të inteligjencës, ato të zbatimit të ligjit dhe personelit që angazhohet në operacionet ushtarake të drejtuara nga NATO-ja për fenomenin e angazhimit të luftëtarëve të huaj në konfliktet aktuale dhe ato të ardhshme në rajon e më gjerë. Kjo qendër ekselence do të kontribuojë në njohjen, parandalimin dhe reduktimin e mundshëm të këtij fenomeni si dhe në rritjen e nivelit të përgatitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të NATO-s në luftën kundër këtij fenomeni në operacionet ku ato janë të angazhuara.

5. Funksionet administrative që do të kryejë Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, janë:

- Kontributi në fushën studimore dhe edukuese për informimin e vendimmarrësve në nivel kombëtar;
- Përgatitja e punonjësve civilë dhe ushtarakë të agjencive të inteligjencës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe personelit që angazhohet në operacionet ushtarake, të drejtuara nga NATO-ja, për fenomenin e angazhimit të luftëtarëve të huaj në konfliktet aktuale dhe ato të ardhshme në rajon e më gjerë;
- Kontributi për njohjen, parandalimin dhe reduktimin e mundshëm të këtij fenomeni;
- Kontributi për rritjen e nivelit të përgatitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të NATO-s në luftën kundër këtij fenomeni, në operacionet ku ato janë të angazhuara;
- Koordinimi i të gjithë procesit dhe ndjekja e procedurave për akreditimin e qendrës;
- Përgatitja e projektakteve të nevojshme për plotësimin e të gjithë kuadrit ligjor;
- Hartimi dhe negocimi i memorandumeve të mirëkuptimit, memorandumeve operacionale dhe funksionale, marrëveshjeve teknike, për funksionimin e qendrës dhe anëtarësimin në të të vendeve të tjera aleate/partnere.

6. Struktura dhe organika e Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, miratohet nga Kryeministri.

7. Personeli i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, do të jetë ushtarak dhe civil. Marrëdhëniet e punës të personelit civil do të rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

## VENDIM
## Nr. 70, datë 3.2.2017

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM, SISTEMIM DHE ASFALTIM I RRUGËVE E TROTUAREVE”, NË BASHKINË E HASIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtim, sistemim dhe asfaltim i rrugëve e trotuareve”, në Bashkinë e Hasit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Hasit.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 473 (katërqind e shtatëdhjetë e tre) $m^2$, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 1 074 183 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 074 183 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Hasit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Hasit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7.Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Hasit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 473 (katërqind e shtatëdhjetë e tre) $m^2$, “truall”, për realizimin e projektit “Ndërtim, sistemim dhe asfaltim i rrugëve e trotuareve”të bëhet në favor të Bashkisë së Hasit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Has dhe Bashkia e Hasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIM, SISTEMIM DHE ASFALTIM TË RRUGËVE DHE TROTUAREVE”, NË BASHKINË E HASIT

| Nr. | Emri mbiemri | Nr. i pasurisë | Zona kadastrale | Sipërfaqja m² truall | Çmimi në lekë/m² | Vlera në lekë | Lloji i dokumentit të pronësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Agim Azem Geca | 4/167 | 2282 | 473 | 2271 | 1074183 | Konfirmim nga ZRPPP-ja |
| | **TOTALI** | | | | | **1 074 183** | |

## VENDIM
## Nr. 71, datë 3.2.2017

## PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I SHËTITORES ‘ALI PASHA’, RESTAURIM I FASADAVE, NDRIÇIM, SISTEMIM TROTUARESH”, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i shëtitores ‘Ali Pasha’, restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”, Bashkia Tepelenë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë "ndërtesë", me sipërfaqe 227.9 (dyqind e njëzet e shtatë pikë nëntë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme prej2 013 023 (dy milionë e trembëdhjetë mijë e njëzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 013 023 (dy milionë e trembëdhjetë mijë e njëzet e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Tepelenë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Tepelenë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Tepelenë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 227.9 (dyqind e njëzet e shtatë pikë nëntë) $m^2$, "ndërtesë", për realizimin e projektit "Rikonstruksion i shëtitores 'Ali Pasha', restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh" të bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë dhe Bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "RIKONSTRUKSIONIT TË SHËTITORES 'ALI PASHA', RESTAURIM I FASADAVE, NDRIÇIM, SISTEMIM TROTUARESH", NË BASHKINË E TEPELENËS

| Nr. | Emri mbiemri | Nr. i pasurisë | Zona kadastrale | Sipërfaqja $m^2$, ndërtim | Vlera në lekë | Lloji i dokumentit të pronësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kastriot Hysa | 10/76-Nj | 3574 | 51.1 | 941335 | Konfirmim nga ZRPPP-ja |
| 2 | Erald Alika | 10/76-Nj | 3574 | 51.7 | 847360 | Konfirmim nga ZRPPP-ja |
| 3 | Fatmir Seiti | 10/76+1-1 | 3574 | 125.1 | 224328 | Konfirmim nga ZRPPP-ja |
| | **TOTALI** | | | | **2 013 023** | |

## VENDIM
## Nr. 72, datë 3.2.2017

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE TË LAGJEVE NË KODËR–VORË, LOTI 1", BASHKIA VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të lagjeve në Kodër–Vorë, loti 1", Bashkia Vorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë "tokë truall", me sipërfaqe 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) $m^2$ , dhe për pasurinë "objekt", me sipërfaqe 42 (dyzet e dy) $m^2$, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 2 025 498 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera epërgjithshme e shpronësimit, prej 2 025 498 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Vorë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Vorë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive "tokë truall", me sipërfaqe 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m², dhe "objekt", me sipërfaqe 42 (dyzet e dy) m² për realizimin e projektit "Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të lagjeve në Kodër-Vorë, loti 1" të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vorë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR "RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGËVE TË LAGJEVE NË KODËR-VORË, LOTI 1", BASHKIA VORË

| Nr. | Emri mbiemri | Nr. i pasurisë | ZK | Lloji i pasurisë | | Vlera e truallit/lekë | Vlera e ndërtesës/lekë | Vlera e shpronësimit në lekë | Lloji i dokumentit të pronësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Truall/m² | Objekt /m² | | | | |
| 1 | Bashkëpronarët Maloku:Haxhire Maloku Inndrit Maloku Alfonc Maloku Adrian Maloku Elvir Maloku (Deliallisi) | 586/6/1 | 2183 | 228 | 42 | 559,056.00 | 1,348,746.00 | 1,907,802.00 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Ismail Karreci | 467/10 | 2183 | 24 | | 58,848.00 | | 58,848.00 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 3 | Kalosh Gjeta | 100/8/1 | 2183 | 24 | | 58,848.00 | | 58,848.00 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| | **TOTALI** | | | | | | | **2,025,498.00** | |

**VENDIM**
**Nr. 73, datë 3.2.2017**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE", BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike", Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë "tokë arë", me sipërfaqe 14 500 (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind) m², me vlerë të përgjithshme prej 3 219 000 (tre milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 219 000 (tre milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Elbasan të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 14 500 (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind) m² "tokë arë" për realizimin e projektit "Zgjerimi i varrezave publike" të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT”, BASHKIA ELBASAN

| Nr. | Emri mbiemri | Nr. i pasurisë | ZK | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja që shpronësohet në m² | Çmimi në lekë/m² | Vlera e shpronësimit në lekë | Lloji i dokumentit të pronësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ahmet Mustafa Kadzadej dhe bashkëpronarët | 227/4 | 8527 | Arë | 3500 | 222 | 777000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Ardian Petrit Burimi dhe bashkëpronarët | 227/5 | 8527 | Arë | 5000 | 222 | 1110000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 3 | Çlirimtar Abedin Kotherja Fatmir Abedin Kotherja | 227/3 | 8527 | Arë | 6000 | 222 | 1332000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| | **TOTALI** | | | | **14500** | | **3219000** | |

## VENDIM
## Nr. 80, datë 8.2.2017

## PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA SHIJAK, TË PRONËS NR. 1131, ME EMËRTIM “ISH-SPITALI”, ME VENDNDODHJE NË SHIJAK, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 839, DATË 22.7.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHIJAK, TË QARKUT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Shijak, të pronës nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një qendre të shërbimeve të integruara, për realizimin e funksioneve dhe të shërbimeve administrative, ekonomike, socialkulturore, të shëndetit publik dhe për kryerjen e funksioneve të veta, në interes të komunitetit në territorin e Bashkisë Shijak.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore publike, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Shijak, me vendimin nr. 839, datë 22.7.2009, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Shijak i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Shijak për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**




**VENDIM**
**Nr. 81, datë 8.2.2017**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA VLORË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË DISA SIPËRFAQEVE NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 904, ME EMËRTIM "AKADEMIA E DETARISË", ME VENDNDODHJE NË SKELË, VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të disa objekteve dhe të sipërfaqeve truall funksional prej 22 009 (njëzet e dy mijë e nëntë) m² dhe prej 3 690 (tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 25 699 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², brenda territorit të pronës nr. 904, me emërtim "Akademia e Detarisë", me vendndodhje në Skelë, Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për zbatimin e projekteve për

ndërtimin e rrugës "Lungomare" dhe për ndërtimin e unazës së qytetit Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, nga prona nr. 904, me emërtim "Akademia e Detarisë", me vendndodhje në Skelë, Vlorë, sipas planvendosjes, të hiqen sipërfaqet truall funksional prej 22 009 (njëzet e dy mijë e nëntë) m² dhe prej 3 690 (tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 25 699 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², përfshirë objektet, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Vlorë.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqeve të pronës, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ose t'ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Para fillimit të punimeve, Bashkia Vlorë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme dhe për këtë, ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe Komandës së Forcës Detare Durrës të hartohet një aktmarrëveshje.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Vlorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**


PLANVENDOSJE
Prona nr. 904 "Akademia e Detarisë" Skelë, Vlorë
SISTEMI I KOORDINATAVE SHTETERORE
MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS DETARE
Gjeneral Major YLBER DOGJANI
Kab. elk
gardh rrjet
gardh
S1=7 363 m²
S2=4 843 m²
S1
SHPJEGUESE
Sipërfaqja e pergjithshme e prones nr 904 S=37 888m²
(përfshihet objekti i ndertuar pa leje rrëzë truprojes)
Sipërfaqja qe preket nga projekti i rrugës "Lungomare"-s S =22 009 m².
Sipërfaqja qe preket nga projekti i unazës S =3690 m²
përfshi obj nr. 7 =132.3 m²
Sipërfaqja që i mbetet prones nr 904 (S1+S2) S = 12 206 m²,
ku : S1=7 363 m², S2=4843 m²
Vija e projektit të rrugës Lungomare
Vija e projektit Unazë
Shënim :
Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MM Nr 6523/1 dt 25.10.2016, sipas dokumentacionit teknik të marrë në arkivin e IGJIU duke hedhur projektin e dërguar në mënyrë elektronike nga Bashkia Vlorë për Unazën e qytetit dhe projektin "Lungomare", si dhe shkresës së FD nr.4260/1, datë 02.11.2016
Nëntor 2016
372 350
372 600
372 750

**VENDIM**
**Nr. 82, datë 8.2.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DORËZIMIT VULLNETAR TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇDO LLOJI DHE TRAJTIMIN E TYRE NGA STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, tëligjit nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR NDJEKJEN DHE ADMINISTRIMIN E PROCESIT TË DORËZIMIT VULLNETAR TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇDO LLOJI

1. Policia e Shtetit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është përgjegjëse për grumbullimin, evidentimin, administrimin e armëve e të materialeve të tjera luftarake, të dorëzuara vullnetarisht nga personat. Përkatësisht, në Policinë e Shtetit, strukturat përgjegjëse për ndjekjen e procesit të dorëzimit vullnetar, marrjes në dorëzim dhe administrimin e armëve të zjarrit, të lëndëve plasëse e të materialeve të tjera luftarake janë:

a) Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit:

i) Drejtoria e Rendit Publik, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike, për monitorimin e procesit të dorëzimit vullnetar, për zbatimin e procedurave gjatë marrjes në dorëzim të armëve të zjarrit e të materialeve të tjera luftarake;

ii) Sektori i marrëdhënieve me publikun, në Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Marrëdhënieve me Publikun, për komunikimin me institucionet e tjera, mediat dhe publikun;

iii) Drejtoria Ekonomike, në Drejtorinë e Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse, për evidentimin, magazinimin, administrimin, deri në dorëzimin në magazinat e Forcave të Armatosura;

iv) Salla e komandimit, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike, për grumbullimin e informacionit nga drejtoritë vendore të policisë, përpunimin e rezultateve dhe raportimin në komunikatën ditore të Policisë së Shtetit.

b) Në drejtoritë vendore të policisë:

i) Sektori i rendit publik, në Drejtorinë Vendore të Policisë, për monitorimin e procesit të dorëzimit vullnetar, për zbatimin e procedurave gjatë marrjes në dorëzim nga qytetarët në banesat e tyre, duke u mbështetur edhe nga të gjithë sektorët e tjerë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë;

ii) Sektori i marrëdhënieve me publikun, në Drejtorinë Vendore të Policisë, për komunikimin me institucionet e tjera, mediat dhe publikun në juridiksionin e Drejtorisë Vendore të Policisë;

iii) Sektori ekonomik, në Drejtorinë Vendore të Policisë, për evidentimin, magazinimin, administrimin e armëve e të materialeve të tjera luftarake, deri në dorëzimin në magazinat e Forcave të Armatosura;

iv) Salla e komandimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë, për grumbullimin e informacionit nga strukturat në varësi të saj, përpunimin e rezultateve dhe raportimin në komunikatën ditore të Drejtorisë Vendore të Policisë, në sallëne komandimit, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike të Policisë së Shtetit;

v) Komisariatet/stacionet e policisë në varësi të drejtorive vendore të policisë, të cilat do të punojnë në terren, duke trokitur derë më derë te qytetarët dhe do të bëjnë thirrje për dorëzimin vullnetar të armëve e të municioneve luftarake.

2. Ministria e Mbrojtjes, e cila është përgjegjëse për marrjen në dorëzim të armëve e të materialeve të tjera luftarake, të grumbulluara nga Policia e Shtetit, dhe trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

II. PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN GJATË PROCESIT TË DORËZIMIT VULLNETAR TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇDO LLOJI

3. Procedura e njoftimit/deklarimit nga personat në strukturat e Policisë së Shtetit:

3.1 Personat, që disponojnë armë zjarri dhe materiale të tjera luftarake pa leje dhe që shprehin dëshirën për t'i dorëzuar vullnetarisht ato, njoftojnë paraprakisht në strukturën më të afërt të drejtorisë, komisariatit, stacionit të Policisë së Shtetit, në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Telefonojnë direkt në numrat e telefonit 112 (për Tiranën) ose 129 të sallave të komandimit pranë drejtorive vendore të policisë/ komisariateve të policisë/stacioneve të policisë, duke dhënë adresën e saktë se ku e mban armën e zjarrit apo materiale të tjera luftarake që dëshiron të dorëzojë, sasinë, llojin që disponon dhe orën kur janë të gatshëm për t'i dorëzuar vullnetarisht ato;

b) Paraqiten personalisht pranë zyrave të shërbimit të qytetarëve/shërbimin e informacionit pranë strukturës vendore policore më të afërt, duke plotësuar një deklaratë me të dhënat dhe adresën e saktë të tij, vendin, sasinë dhe llojin e armës apo materialeve të tjera luftarake që dëshiron të dorëzojë vullnetarisht.

c) Në rrugë elektronike, duke dërguar e-mail në adresat elektronike të Policisë së Shtetit (policiaeshtetit@gmail.com)apo komisariatit dixhital.

3.2 Në momentin e deklarimit, punonjësi i policisë udhëzon personin që nuk duhet të qarkullojë me armën e zjarrit apo materiale të tjera luftarake, deri në paraqitjen e punonjësit të policisë për marrjen në dorëzim të tyre.

3.3 Shtetasi, që ka deklaruar në strukturat e policisë për disponimin e armës së zjarrit të çdo lloji apo materialeve të tjera luftarake, i mban ato në ambientin që ka deklaruar, deri në momentin e marrjes në dorëzim nga punonjësi i policisë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Marrja në dorëzim e armës së zjarrit dhe materialeve të tjera luftarake nga punonjësi i Policisë së Shtetit:

4.1 Policia e Shtetit, pas marrjes së informacionit nga personi se ai disponon një armë zjarri, municione luftarake, lëndë plasëse apo materiale të tjera luftarake pa lejen e organeve kompetente, të cilat dëshiron t'i dorëzojë, organizon masat për dorëzimin e tyre, si më poshtë vijon:

a) Brenda 24 orëve në adresën e dhënë nga personi paraqitet punonjësi i policisë (ndihmësspecialisti i policimit në komunitet);

b) Punonjësi i policisë (ndihmësspecialisti i policimit në komunitet) përpilon procesverbalin e marrjes në dorëzim të armës/materialeve të tjera luftarake, i cili mbahet në dy kopje dhe pasi nënshkruhet një kopje e tij i jepet personit;

c) Në raste të veçanta, kur shtetasi që disponon armë zjarri apo materiale të tjera luftarake dëshiron t'i dorëzojë ato, por kërkon të mos nënshkruajë procesverbalin e dorëzimit, duhet të jenë prezent jo më pak se dy punonjës policie, të cilët nënshkruajnë procesverbalin dhe pasqyrojnë refuzimin e nënshkrimit nga personi;

ç) Punonjësi i policisë, i cili ka marrë në dorëzim armën apo materiale të tjera luftarake, i dorëzon menjëherë në magazinën e armatimit të strukturës vendore të Policisë së Shtetit, të shoqëruar me procesverbalin, duke informuar sallën e komandimit.

5. Gjetja e armëve të zjarrit dhe materialeve të tjera luftarake në ambiente të ndryshme:

5.1 Në rast të konstatimit të armëve të zjarrit apo materialeve të tjera luftarake në vende /ambiente të ndryshme, strukturat e Policisë së Shtetit do të kryejnë veprimet procedurale sipas Kodit të Procedurës Penale.

6. Ekspertimi balistik i armëve të zjarrit të dorëzuara vullnetarisht:

6.1 Të gjitha armët e zjarrit të dorëzuara vullnetarisht i nënshtrohen ekspertimit balistik sipas procedurave standarde për këtë qëllim.

III. REGJISTRIMI, ADMINISTRIMI I ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇDO LLOJI DHE MATERIALEVE TË TJERA LUFTARAKE TË DORËZUARA

7. Struktura përgjegjëse për magazinimin, administrimin, grumbullimin dhe asgjësimin e armëve e të materialeve të tjera luftarake:

7.1Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit) është përgjegjëse për grumbullimin, evidentimin, administrimin e armëve e të materialeve të tjera luftarake, të dorëzuara vullnetarisht. Administrimi i armëve dhe i materialeve të tjera luftarake bëhet në magazinat e armatimit, në kolonë të veçantë si armë të dorëzuara nga shtetasit. Regjistrimi i tyre bëhet në regjistra dhe në sistemin elektronik të regjistrimit të armëve.

7.2Armatimi dhe materialet e tjera luftarake të grumbulluara nga Ministria e Punëve të Brendshme i dorëzohen Ministrisë së Mbrojtjes, e cila bën trajtimin e mëtejshëm të tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

IV. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET, MEDIAN DHE PUBLIKUN

8. Njoftimi për rezultatet e procesit të dorëzimit të armëve të zjarrit dhe materialeve të tjera luftarake:

8.1 Të gjitha armët e zjarrit apo materialet e tjera luftarake të grumbulluara nga strukturat e Policisë së Shtetit do të evidentohen dhe do të raportohen çdo ditë në komunikatën e Policisë së Shtetit.

8.2 Policia e Shtetit në nivel qendror dhe vendor komunikon me publikun për procesin dhe rezultatet e evidentuara.

9. Bashkëpunimi me institucionet, median dhe publiku:

9.1 Në procesin e sensibilizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve të zjarrit e të materialeve të tjera luftarake, drejtuesit vendorë të policisë bashkëpunojnë me prefektin e qarkut, kryetarin e bashkisë, drejtuesit e njësive administrative, drejtoritë arsimore, institucione të tjera shtetërore, organizatat e të drejtave të njeriut, institucionet fetare, ato të shoqërisë civile dhe mediat, të cilat ngarkohen ose jo me detyra në këtëproces.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

10. Miratimi i modelit të deklaratës dhe i procesverbalit për dorëzimin e armës së zjarrit dhe materialeve të tjera luftarake:

10.1 Drejtori i Policisë së Shtetit, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton modelin e deklaratës dhe të procesverbalit që përpilojnë punonjësit e Policisë së Shtetit në procesin e dorëzimit vullnetar të armëve të zjarrit e të materialeve të tjera luftarake.

11. Magazinimi i armëve të zjarrit dhe materialeve luftarake:

11.1 Armatimi dhe materialet e tjera luftarake, të grumbulluara nga Ministria e Punëve të Brendshme, dorëzohen në vendin e përcaktuar nga Ministria e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**VENDIM**
**Nr. 83, datë 8.2.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 687, DATË 5.10.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA, SI DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, dhe 34, pika 2, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, të nenit 22, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 687, datë 5.10.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e bazës ligjore dhe kudo në vendim, titulli i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të jetë "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

2. Pika 4, e kreut I ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.".

3. Pika 5, e kreut I, ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Agjencia drejtohet nga kryeadministratori. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.".

4. Pika 2.3, e kreut VII, ndryshon si më poshtë vijon:

"2.3. Procedurat e kryerjes së shpenzimeve realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.".

II. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**VENDIM**
**Nr. 84, datë 8.2.2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 56 e 159, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqen kodet sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**LISTA**

| **Kodi** | **Përshkrimi** |
|---|---|
| 39172390 | – – Tuba plastikë të përforcuar me fibra qelqi për hidrocentrale |
| 39172900 | – – Prej plastikeve të tjera |
| 70199000 | – Tuba me fibra qelqi të përforcuar me plastikë për hidrocentrale |
| 73042990 | – – – Të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm |
| 73043998 | – – – – – Më tepër se 406,4 mm |
| 73044100 | – – Të tërhequr në të ftohtë apo të petëzuar në të ftohtë |
| 73044999 | – – – – Të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm |
| 73045999 | – – – – Të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm |
| 73051100 | – – Hark gjatësor i fundosur i salduar |
| 73053100 | – – Të salduar për së gjati |
| 73072910 | – – – Të filetuara |
| 73079391 | – – – – Bërrylat dhe përkuljet |
| 84041000 | – Impiantet ndihmëse për t'u përdorur me kaldajat e kreut 8402 apo 8403 |
